



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

VENDIM

K.P.P. 106/2019

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 25.02.2019, shqyrtoi ankesat me:

Objekt: Shfuqizimin e vendimit të KVO-së për skualifikimin e ofertës të operatorit ekonomik “Kevin Konstruktion” sh.p.k., në procedurën e prokurimit, “*Procedurë e hapur*”, me objekt, “*Ndërtimi i pedonales dhe korsisë së bicikletave të Liqenit Belshit, Faza III*”, me nr. REF-94803-11-20-2018, me fond limit 155,703,178 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 21.12.2018, nga autoriteti kontraktor, Fondi Shqiptar i Zhvillimit.

Ankimues: Operatori ekonomik “Kevin Konstruktion” sh.p.k
Adresa: Rr. “Adem Jashari”, Nd.4, H.10, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor: Fondi Shqiptar i Zhvillimit
Adresa: Rr. “Sami Frashëri”, Nr. 10, Tiranë.

Baza Ligjore: *Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.*

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës dhe të dokumentacionit të dërguar nga operatori ekonomik ankimues dhe autoriteti kontraktor, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se, mbështetur në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, operatori ekonomik ankimues kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.2. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe, më pas, ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”.

I.3. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës të operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1 Në datën 21.11.2018, në sistemin e prokurimeve elektronike është publikuar procedura e prokurimit, “*Procedurë e hapur*”, me objekt, “*Ndërtimi i pedonales dhe korsisë së bicikletave të Liqenit Belshit, Faza III*”, me nr. REF-94803-11-20-2018, me fond limit 155,703,178 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 21.12.2018, nga autoriteti kontraktor, Fondi Shqiptar i Zhvillimit.

II.2 Në datën 21.12.2018, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Në datën 09.01.2019, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezulton si më poshtë vijon:

1. “Fled” & ”Shkëlqimi 07” & ”Grand Konstruksion M” shpk	96,217,571 lekë, Skualifikuar;
2. ”Kevin Konstruksion” shpk	96,351,774 lekë, Skualifikuar;
3. “Vëllezërit Hysa” shpk	101,503,501 lekë, Kualifikuar;
4. “Blerimi” & ”Bajrami N” shpk	105,106,042 lekë, Skualifikuar;
5. “Kacdedja” & ”Agri Construction” shpk	108,925,852 lekë, Kualifikuar;
6. “Eurondërtim 2000” shpk	112,871,557 lekë, Kualifikuar;
7. “Liqeni VII” & ”Kupa” shpk	127,284,230 lekë, Kualifikuar;
8. “Kthella” shpk	129,499,428 lekë, Kualifikuar;
9. “Curri” shpk	132,210,134 lekë, Kualifikuar;
10. “Isobar Construction” shpk	pa ofertë ekonomike, Skualifikuar;

II.4.Me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorin ekonomik “Kevin Konstruktion” sh.p.k. për skualifikimin e ofertës së tij, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, me arsyetimin si më poshtë vijon:

“Shoqeria “Kevin Konstruktion” shpk nuk ploteson kërkesen 2.2.3 per kualifikim lidhur me detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, pasi referuar puneve te ngjashme te deklaruar ka kryer aktivitet ne Kukes ne objektin “Rruga Borje – kufi me Kosovën” dhe nuk ka paguar detyrimet vendore. Shoqeria “Kevin Konstruktion” shpk nuk ploteson kërkesen 2.3.1 per kualifikim lidhur me punet e ngjashme pasi ka paraqitur dy kontratat: “Rikualifikim urban i bllokut kufizuar nga rruga “Ibrahim Rrugova”, “Pjeter Bogdani” “Gjin Bue Shpata” dhe bulevardi “Bajram Curri” me vlere 39.762.162 leke pa tvsh dhe “Rruga Borje – kufi me Kosoven” me vlere 53.317.647 leke pa tvsh. Me keta dy objekte nuk ploteson asnje prej kushteve pasi vlere e objektit me te madh te deklaruar eshte 53.317.647 leke pa tvsh nga 77.851.589 leke pa tvsh qe eshte kërkesa dhe vlere e plote e te dy objekteve te deklaruar eshte 93.079.809 leke pa tvsh nga 311.406.356 leke pa tvsh qe eshte kërkesa (bazuar ne perqindjen e puneve qe ka marre persiper). Duke qene se keto te meta jane thelbesore, komisioni vendosi te mos vazhdoje me me shqyrtimin e dokumentacionit te mbetur per kete bashkim shoqerish.”

II.5.Në datën 16.01.2019 operatori ekonomik “Kevin Konstruktion” sh.p.k. ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e autoritetit kontraktor për skualifikimin e ofertës së tij, në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, duke argumentuar si më poshtë vijon:

“[...]A.Ne lidhje me arsyen e pare te skualifikimi sqarojme se: Ne kritert e vecanta te kualifikimit, autoriteti ka kerkuar: “Operatori ekonomik duhet te paraqese nje deklarate me shkrim nga administratori se subjekti ka paguar te gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, ne vendet ku operatori ka ushtruar apo ushtron aktivitet per periudhen nga 01.01.2017 deri me 15.11.2018. Kesaj deklarate duhet ti bashkangjiten te gjitha vertetimet qe deshmojne se operatori ekonomik ka paguar detyrimet perkatese, ne vendet ku ka ushtruar apo ushtron aktivitet per kete periudhe, shoqeruar me mandatet perkatese te pagesave”

Ne permbushje te ketij kriteri, shoqeria jone ka ngarkuar ne (SPE), dokumentacionin si ne vijim:

- 1. Deklarate e administratorit te shoqerise me ane te se ciles vertetohet se jane shlyer te gjitha taksat dhe tarifate vendore per vitin 2017 dhe 2018 per te gjitha adresat e rregjistruara ne QKB ku eshte ushtruar apo ushtrohet aktivitet;*
 - 2. Vertetim Nr.134997/1Prot, date 27.07.2017, leshuar nga Bashkia Tirane, per shlyerjen e tarifave dhe taksave vendore per vitin 2017;*
 - 3. Vertetim Nr.1446/1Prot, date 13.01.2017, leshuar nga Bashkia Tirane, per shlyerjen e tarifave dhe taksave vendore per vitin 2017;*
- Mandat Pagesat për vitin 2017.*
- 4.Mandat Pagese date 19.04.2017, per shlyerjen e pageses se takses vendore per reklamen, per vitin 2017;*
 - 5. Mandat Pagese date 19.04.2017, per shlyerjen e pageses se takses vendore per pastrim, per vitin 2017;*
 - 6. Mandat Pagese date 19.04.2017, per shlyerjen e pagesa se takses vendore, per infrastrukturen arsimore per vitin 2017;*

7. Vërtetimin Nr.2034/IProt, date 05.03.2018, leshuar nga Bashkia Tirane, per shlyerjen e tarifave dhe taksave vendore per vitin 2018;

Mandat Pagesat për vitin 2018

8. Mandat Pagese date 19.06.2018, per shlyerjen e pageses se takses vendore per reklamen, per vitin 2018;

9. Mandat Pagese date 02.03.2018, per shlyerjen e pageses se takses vendore per pastrim, per vitin 2018;

10. Mandat Pagese date 02.03.2018, per shlyerjen e pageses se takses vendore, per infrastrukturen arsimore, per vitin 2018;

11 . Mandate Pagese date 02.03.2018, per shlyerjen e takses se pastrimit per vitin 2018;

Neni 12 “Rregjistrimi dhe Liçensimi” i Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar parashikon se: Taksapaguesit, subjekte të këtij ligji, regjistrohen, për qëllime fiskale, pranë Qendrës Kombëtare të regjistrimit, në përputhje me ligjin e posaçëm. Ndryshimet në vendin e ushtrimit të veprimtarisë dhe të të dhënave të tjera tregtare kryhen sipas dispozitave të ligjit për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

Ndërkohë, nga shqyrtimi i Ekstraktit Historik të Rregjistrimit Tregtar të shoqërisë sonë, të shkarkuar nga Sistemi E-Albania, rezulton se adresat ku ka ushtruar dhe që ushtrojmë ende aktivitetet në vitin 2017 dhe vitin 2018, janë si ne vijim: “Zyra qendrore e shoqërisë, Rruga “Adem Jashari, Nd. 4, Hy.10, Njesia Bashkiake Nr. 5, Tirane ””, nderkohe qe nuk ka “Vënde të tjera të ushtrimit të aktivitetit”. Në nenin 46, pika 1 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese”. Në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: “Autoriteti kontraktor në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit... Sa më sipër, shoqëria jone gjykon se me dokumentacionin e paraqitur nga ana jone, vërtetohet se kemi shlyer detyrimet për taksat e tarifave vendore ndaj të gjitha bashkive ku jemi regjistruar, për qëllime fiskale, pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit/Regjistrimit, në përputhje me ligjin e posaçëm për të gjithë periudhën e specifikuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit. Këto vërtetime kanë dhënë informacion të mjaftueshëm për të krijuar bindjen se shoqëria jone nuk është debitor i Bashkisë Kukes për taksat vendore të vitit 2017 dhe 2018. Akoma me tej, referuar edhe Vendimeve të Komisionit të Prokurimeve Publike, i cili merr vendime përfundimtare administrativisht, është shprehur qartësisht për raste të ngjashme se operatori ekonomik është i detyruar të shlyejë taksat vendore vetëm për vendet e ushtrimit të aktivitetit të regjistruara në QKB. Konkretisht, Komisioni i Prokurimeve Publike me ane të Vendimit Nr. KP.P. 335/2016 datë 16.05.2016 ka vendosur: (Citim...) Vendimit Nr. K.P.P 266/2016, datë 25.04.2016, ka vendosur: (Citim...)

Përsa me sipër parashtruar, pretendimi i autoritetit kontraktor nuk qëndron pasi nuk është i bazuar në ligj.

B.Ne lidhje me arsyen e dyte te skualifikimi sqarojme se: Shoqëria jone ka paraqitur në tender gjithë dokumentacionin ligjor të kërkuar për punën e ngjashme, në vlerat e kërkuara nga autoriteti kontraktor. Vlera e kontratës “Ruga Borje-Kufi me Kosoven” me TVSH e plotëson vlerën e kërkuar nga autoriteti kontraktor për punën e ngjashme. Përsa me sipër parashtruar, pretendimi i autoritetit kontraktor nuk qëndron pasi nuk është i bazuar në ligj. [...]”

II.6. Nga verifikimet e kryera në dokumentacionin e paraqitur pranë KPP, me anë të shkresës Nr. 63/1 Prot. datë 17.01.2019, autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues “Kevin Konstruksion” sh.p.k, duke mos e pranuar ankesën e paraqitur prej tij, si dhe duke i qëndruar argumentimit të komisionit të vlerësimit të ofertave.

II.7.Në datën 25.01.2019 operatori ekonomik ”Kevin Konstruksion” sh.p.k ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt me ankesën e dorëzuar pranë autoritetit kontraktor, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, duke shtuar pretendimin si më poshtë vijon:

“[...]Shoqeria jone ka paraqitur ne tender kontratat si me poshte:

1.Vazhdimi i ndërtimit të kampusit të ri Universitar, godina e dytë, për Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës ” me vlere 636,303,341.

2.Shtesë kontrate prej 17.76% Vazhdimi i ndërtimit të kampusit të ri Universitar, godina e dytë, për Universitetin “Aleksandër Moisiu ” Durrës me vlere 113,000,638.

3.Shtesë kontrate prej 2.2% Vazhdimi i ndërtimit të kampusit të ri Universitar, godina e dytë, për Universitetin “Aleksandër Moisiu ” Durrës ” me vlere 14,020,363.

4. “Punime per sistemime te jashtme ne godihen e dyte te Universitetit “Aleksander Moisiu Durrës, te ndertuar ne truallin e kampusit te ri, Spitali, Durrës ” me vlere 53,793,350.

5. “Rikonstruksioni dhe rehabilitimi i qendres kulturore te femijeve ” me vlere 42,872,763.

6. “Rruga Borje-Kufi me Kosoven ” me vlere 74,980,053.

7. “Zbatimi i projektit per rrjetet e jashtme inxhinierike te paraburgimit/burgut Shkodër” me vlere 63,942,321.

8. “Rikonstruksion rrjeti TU TM + Ndertim rrjeti TU me kabell ABC + Ndertim kabine ajrore dhe Rrjet TU me kabell ABC, Rajoni Kukes ” me vlere 14,126,853.

9. “Investim ne rrjetin elektrik ne qytetin e Burrelit” me vlere 59,842,778.

10. “Rikonstruksion i salles se kompresoreve transformatoreve dhe Magazina ne Hec Vau i Dejes” me vlere 25,702,195.

11. “Rikualifikimi Urban I bllokut te kufizuar nga rruga “Ibrahim Rrugova” “Pjeter Bogdani” ”Gjin Bue Shpata” dhe bulevardi Bajram Curri” me vlere 47,714,595.

12. “Rikonstruksion i ambienteve ne katin e trete ne godinen 6-kateshe (pathologjia e barres) ” me vlere 47,714,595.

13. “Rikonstruksion i plote ishkolles 9-vjecare “Niket Dardani” me vlere 94,321,41.

II.8.Në datën 01.02.2019, autoriteti kontraktor me anë të shkresës nr.63/3prot., datë 30.01.2019, ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacionin e kërkuar në lidhje me procedurën e prokurimit të sipërcituar.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dhe kërkesës të operatorit ekonomik ankimues,

Arsyeton:

III.1.Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Kevin Konstruksion” sh.p.k mbi skualifikimin e ofertës së tij me arsyen: *“[...]Shoqeria “Kevin Konstruksion” shpk nuk ploteson kerkesen 2.3.1 per kualifikim lidhur me punet e ngjashme pasi ka paraqitur dy*

kontratat: “Rikualifikim urban i bllokut kufizuar nga rruga “Ibrahim Rrugova”, “Pjeter Bogdani” “Gjin Bue Shpata” dhe bulevardi “Bajram Curri” me vlere 39.762.162 leke pa tvsh dhe “Rruga Borje – kufi me Kosoven” me vlere 53.317.647 leke pa tvsh. Me keta dy objekte nuk ploteson asnje prej kushteve pasi vlere e objektit me te madh te deklaruar eshte 53.317.647 leke pa tvsh nga 77.851.589 leke pa tvsh qe eshte kerkesa dhe vlere e plote e te dy objekteve te deklaruar eshte 93.079.809 leke pa tvsh nga 311.406.356 leke pa tvsh qe eshte kerkesa (bazuar ne perqindjen e puneve qe ka marre persiper)[...]”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1.Në shtojcën nr. 12, pika 2.3.1 e “Kapaciteti teknik” në dokumentat standarte të tenderit në procedurën e prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

“2.3.1 Operatori Ekonomik duhet te kete realizuar punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më pak se 50% e vleres se fondit limit dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, ose punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlere monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku, gjatë tri viteve të fundit, është jo më pak se 200% e vleres se fondit limit.

Plotësimi i njërit prej 2 kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Per te vertetuar plotesimin e ketij kushti Operatori Ekonomik duhet te paraqese punet sipas tabelës se mëposhtme:

NR	OBJEKTI I KONTRATES	DATA E FILLIMIT	DATA E PËRFUNDIMIT	VLERA PA TVSH	VLERA E REALIZUAR NE 3 VITET E FUNDIT

Per secilen pune duhet te paraqiten formularet e vleresimit sipas shtojces perkatese te DST te shoqeruar me kontraten/kontratat e nenshkruara nga palet, situacionet perfundimtare, aktet e kolaudimit dhe faturat tatimore perkatese”

III.1.2.Nga verifikimi i kryer në SPE, rezulton se në përmbushje të kriterit të sipërcituar, operatori ekonomik ankimues ka paraqitur dokumentacionin si vijon :

1. Kontratë nr.7283prot., datë 15.07.2015, lidhur ndërmjet shoqërisë “Kevin Konstruktion” sh.p.k. dhe Bashkisë Tiranë, me objekt “Rikualifikimi urban i bllokut i kufizuar nga rruga “Ibrahim Rrugova”, “Pjetër Bogdani”, “Gjin Bue Shpata” dhe Bulevardi “Bajram Curri””, me vlerë të realizuar 47,714,595.1 lekë me TVSH, shoqëruar me formular vlerësimi, situacionet e punimeve, akt kolaudimi dhe faturat tatimore.
2. Kontratë nr.1551/1prot., datë 13.12.2018, lidhur ndërmjet shoqërisë “Kevin Konstruktion” sh.p.k. dhe Fondit Shqiptar të Zhvillimit, me objekt “Rruga Borje – Kufi me Kosovën”, me vlerë të realizuar 63,980,053.91 lekë me TVSH, shoqëruar me formular vlerësimi, situacionet e punimeve, akt kolaudimi, certifikatë e përfundimit të punimeve, relacion teknik dhe faturat tatimore.
3. Deklaratë e përfaqësuesit ligjor të shoqërisë “Kevin Konstruktion” sh.p.k., lidhur me punët e ngjashme të paraqitura në ofertën për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi.

III.1.3.Në nenin 46, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.” Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcakohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në

përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit.”

III.1.4. Në nenin 26, pika 6, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, përcaktohet: *“6.Për të provuar përvojë në mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon:a)punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit. b)punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë tri viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet. Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme. Autoriteti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik ku të shënohen vlera, koha dhe natyra e punës së bërë dhe çdolloj dokumenti tjetër, që parashikohet në legjislacionin në fuqi, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshmetë punëve. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti kontraktor kërkon si dëshmi vërtetime ku të shënohen vlera, koha dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdolloj dokumenti tjetër, që parashikohet në legjislacionin në fuqi, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.”*

III.1.5. Referuar dokumentacionit të sipërcituar, të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “Kevin Konstruksion” sh.p.k. në përmbushje të kriterit për eksperiencë të ngjashme gjatë tre viteve të fundit, ky i fundit ka paraqitur në sistemin elektronik të prokurimeve Kontratë nr.7283prot., datë 15.07.2015, lidhur ndërmjet shoqërisë “Kevin Konstruksion” sh.p.k. dhe Bashkisë Tiranë, me objekt “Rikualifikimi urban i bllokut i kufizuar nga rruga “Ibrahim Rrugova”, “Pjetër Bogdani”, “Gjin Bue Shpata” dhe Bulevardi “Bajram Curri””, me vlerë të realizuar 47,714,595.1 lekë me TVSH, shoqëruar me formular vlerësimi, situacionet e punimeve, akt kolaudimi dhe faturat tatimore, Kontratë nr.1551/1prot., datë 13.12.2018, lidhur ndërmjet shoqërisë “Kevin Konstruksion” sh.p.k. dhe Fondit Shqiptar të Zhvillimit, me objekt “Rruga Borje – Kufi me Kosovën”, me vlerë të realizuar 63,980,053.91 lekë me TVSH, shoqëruar me formular vlerësimi, situacionet e punimeve, akt kolaudimi, certifikatë e përfundimit të punimeve, relacion teknik dhe faturat tatimore, si dhe Deklaratë e përfaqësuesit ligjor të shoqërisë “Kevin Konstruksion” sh.p.k., lidhur me punët e ngjashme të paraqitura në ofertën për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, në të cilën konstatohet se janë deklaruar vetëm kontratat e sipërcituara. Nga shqyrtimi i këtij, dokumentacioni, Komisioni konstaton se operatori ekonomik ankimues nuk e përmbush vlerën prej 50 % të fondit limit të kontratës që prokurohet me një kontratë të vetme, e cila referuar fondit limit duhet të jetë jo me pak se 77,851,589 lekë, si dhe nuk plotëson as kushtin prej 200 % të fondit limit të kontratës që prokurohet me disa kontrata, të cilat referuar fondit limit duhet të jenë në vlerë totale jo me pak se 311,406,356 lekë. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues se ka paraqitur në këtë procedurë prokurimi kontratat 1.Vazhdimi i ndërtimit të kampusit të ri Universitar, godina e dytë, për Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës ” me vlere 636,303,341. 2.Shtesë kontrate prej 17.76% Vazhdimi i ndërtimit të kampusit të ri Universitar, godina e dytë, për Universitetin “Aleksandër Moisiu ” Durrës me vlere 113,000,638. 3.Shtesë kontrate prej 2.2% Vazhdimi i ndërtimit të kampusit të ri Universitar, godina e dytë, për Universitetin “Aleksandër Moisiu ” Durrës ” me vlere 14,020,363. 4.“Punime per sistemime te jashtme ne godihen e dyte te Universitetit “Aleksander Moisiu Durrës, te ndertuar ne truallin e kampusit te ri, Spitali, Durrës ” me vlere 53,793,350. 5.“Rikonstruksioni dhe rehabilitimi i qendres kulturore te femijeve ” me vlere 42,872,763. 6.“Rruga Borje-Kufi me Kosoven ” me vlere 74,980,053. 7.“Zbatimi i projektit per

rrjetet e jashtme inxhinierike te paraburgimit/burgut Shkodër” me vlere 63,942,321. 8. “Rikonstruksion rrjeti TU TM + Ndertim rrjeti TU me kabell ABC + Ndertim kabine ajrore dhe Rrjet TU me kabell ABC, Rajoni Kukes ” me vlere 14,126,853. 9. “Investim ne rrjetin elektrik ne qytetin e Burrelit” me vlere 59,842,778. 10. “Rikonstruksion i salles se kompresoreve transformatoreve dhe Magazina ne Hec Vau i Dejes” me vlere 25,702,195. 11. “Rikualifikimi Urban I bllokut te kufizuar nga rruga “Ibrahim Rrugova” “Pjeter Bogdani” ”Gjin Bue Shpata” dhe bulevardi Bajram Curri” me vlere 47,714,595. 12. “Rikonstruksion i ambienteve ne katin e trete ne godinen 6-kateshe (pathologjia e barres)” me vlere 47,714,595. 13. “Rikonstruksion i plote ishkolles 9-vjecare “Niket Dardani” me vlere 94,321,41, nga verifikimi i imtësishëm i dokumentacionit të paraqitur nga ankimuesi në sistemin elektronik të prokurimeve, nuk rezulton të jenë paraqitur kontratat e sipërcituara, me përjashtim të dy kontratave (paragrafi III.1.2) të deklaruara edhe nga vetë ankimuesi ne deklaratën përkatëse.

III.1.6.Referuar legjislacionit për prokurimin publik, Komisioni gjykon se, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës në respekt të nenit 46 pika 1 gërma “b”, të Ligjit Nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar . Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme. Në këto kushte, KPP gjykon se operatori ekonomik “Kevin Konstruksion” sh.p.k. nuk ka paraqitur dokumentacion që të provojë se ka kryer punime të ngjashme në vlerën e caktuar nga autoriteti kontraktor, e për rrjedhojë nuk përmbush kriterin e vendosur nga ky i fundit në shtojcën nr. 12, pika 2.3.1 e “Kapaciteti teknik” në dokumentat standarte të tenderit në procedurën e prokurimit objekt ankimi.

III.1.7. Kuadri ligjor parashikon një sërë elementësh si garanci për operatorët ekonomikë të cilët kanë paqartësi në lidhje me intepretimin e kërkesave të autoritetit kontraktor dhe/ose mënyrës së plotësimit të kriterëve kualifikuese. Në rast se operatori ekonomik ankimues do të kishte paqartësi në lidhje mbi plotësimin e kërkesës së mësipërme, ka patur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë autoritetit kontraktor deri në pesë ditë para dorëzimit të ofertave parashikuar nga neni 42 i LPP-së. Në nenin 42, pika 1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se “[...] Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 5 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t’ia komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit [...]”

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Kevin Konstruksion” sh.p.k nuk qëndron.

III.2.Lidhur me pretendimet e tjera të operatorit ekonomik ankimues "Kevin Konstruksion" sh.p.k. për skualifikimin e ofertës së tij, në procedurën e prokurimit objekt ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se për sa kohë që pretendimet e mësipërme nuk qëndrojnë, pasi operatori ekonomik nuk përmbush kriterin e veçantë të kualifikimit dhe gjendja e tij faktike juridike pas arsyetimit të K.P.P. do të mbetet e skualifikuar, shqyrtimi në themel i pretendimeve të tjera të palës ankimuese nuk ndryshojnë gjendjen juridike të këtij operatori ekonomik e për rrjedhojë nuk do të merren në shqyrtim në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 "Për miratimin e rregullave "Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik", Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik "Kevin Konstruksion" sh.p.k, për procedurën e prokurimit "*Procedurë e hapur*", me objekt, "*Ndërtimi i pedonales dhe korsisë së bicikletave të Liqenit Belshit, Faza III*", me nr. REF-94803-11-20-2018, me fond limit 155,703,178 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 21.12.2018, nga autoriteti kontraktor, Fondi Shqiptar i Zhvillimit.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit të sipërcituar.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 126 protokoli Datë 25.01.2019;

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha